



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 108/5 Prot.

Tiranë, më 18.07.2016

VENDIM I NDËRMJETËM

PËR MIRATIMIN E REZULTATEVE TË KONTROLLIT TË SIGURIMIT TË CILËSISË NË TË FTOHTË TË AUDITIMIT TË INICIUAR NË “AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT” NË BAZË TË URDHËRIT TË KRYETARIT NR. 83, DATË 18.07.2016

Pasi u njoha me rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë në të ftohtë të iniciuar në bazë të Urdhrit të Kryetarit të KLSH nr. 83, datë 18.07.2016 në “Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, si dhe konfirmimin e dhënë Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Drejtori i Përgjithshëm dhe Sekretari i Përgjithshëm, mbështetur në nenin 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë në të ftohtë, paraqitur nga grupi i kontrollit të sigurimit të cilësisë i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.
- II.** Rezultatet e kontrollit të sigurimit të cilësisë në të ftohtë të dalin me një Raport dhe Vendim të veçantë Auditimi.
- III.** Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

K R Y E T A R

Bujar LESKAJ